



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.92 dt.20.07.2001

**PER  
NDRYSHIMIN NE LIMITIN E TE ARDHURAVE PER VITIN 2001**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligjit 7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2001 për Bashkinë Tiranë”, Vendimin Nr.43 dt.27.04.2001, Ligjit Nr.7818 dt.19.12.2000 “Për buxhetin e shtetit për vitin 2001”, në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2 dt.02.02.2001 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2001”, pikës III.3, ku shprehimisht thuhet”..... transferimet lejohen të kryhen 1 herë në 2 muaj”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të shtojë limitin e shpenzimeve operative për vitin 2001 në masën 35000 mijë lekë duke pakësuar limitin e investimeve në zërin “Mjete transporti, rikonstruksion dhe pajisje”, për ndërmarrjen Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit në masën 30.000 mijë lekë dhe në zërin “Ndërtim i Urës mbi Lanë që lidh dy segmentet e rrugës “Dëshmorët e 4 Shkurtit” në shumën prej 5.000 mijë lekë
2. Fondet operative sipas pikës 1 të këtij vendimi të detajohen si më poshtë:

	Art600	Art601	Art602
- Ndërmarrja Nr.1 e P. të Qytetit			10000
- Aparati i Bashkisë	3150	2000	10000
- Policia Bashkiake	3600	1250	5000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Financës
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**

